


Autoriteti i likuidimit për NSH "Tregu" publikon këtë:

NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT

Njoftim për zgjatjen e afatit për aplikim në shpalljen publike të datës 22.01.2024 për 3 pozita për vendin e punës Ofrues i Shërbimeve – Udhëheqës/e e Tregut të NSH "Tregu" me Nr. të referencës 22012024.

Afati për aplikim zgjatet për shkak se numri i aplikacioneve të pranuar nuk ka qenë i mjaftueshëm. Afati zgjatet edhe për 15 ditë përkatësisht shpallja mbetet e hapur deri me datë 20.02.2024 në ora 16:00.

Nënshkrimi



Autoriteti i Likuidimit për NSH "Tregu"

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 06/2020 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve Udhëheqës/e i/e Tregut
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujor
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	500.00 Euro
Nr. i kërkuar	3
Data e njoftimit	22.01.2024
Afati për aplikim	29.01.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH “Tregu” -Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	22012024

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i Shërbimeve angazhohet për ruajtjen dhe ngritjen e vlerës së pronës shoqërore.;
- Mbikëqyr, menaxhon dhe koordinon punën në Tregun përkatës-së dhe koordinon dhe mbikëqyrë personelin që i përket atij tregu;
- Mbikëqyrje dhe udhëzime si dhe trajnim për stafin në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme;
- Monitoron kontrollimin e kualitetit të punës në tregun përgjegjës;
- Mbikëqyrë aktivitetet ditore të Ofruesve të Shërbimeve, siguron dhe vlerëson efektivitetin në kryerjen e detyrave të tyre ditore, i raporton Zyratrit të Rastit lidhur me aktivitet ditore në Tregun përkatës.
- Koordinon dhe lehtëson komunikimin në mes qiramarrësve, trajton qështjet dhe problemet ditore që lidhen me funksionimin e tregut dhe sanimin e pengesave eventuale.
- Përgatit raporte ditore, javore, mujor apo sipas kërkeses dhe raporton ne baza javore tek zyrtari I rastit Nuk përjashtohet raportimi i drejtpërdrejt në rastet kur është e nevojshme.
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
 - Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
-

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar:

- Diplomë universitare në Biznes, Ekonomi, Financa, Kontabilitet, Juridik apo ngjajshme;
- Njohuri të mirë pune me pakon e programeve të Microsoft Office
- Përvojë paraprake në biznes do të jetë përparësi;
- Të jetë i përpiktë dhe të ketë aftësi organizative;
- Aftësi të punoj në punë ekipore si dhe në mënyrë të pavarur me mbikëqyrje të vogël;

4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit.

6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 20.02.2024, në ora 14:00 në emalin punesimi@pak-ks.org.

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 27.02.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-